

Kërkesa mund të dorëzohet pranë Ministrisë së Drejtësisë dorazi ose me postë drejtuar Komisionit të Licencimit të Ndërmjetësve, në adresën “Ministria e Drejtësisë, Bulevardi Zog i I-rë Tiranë”.

Formulari i kërkesës duhet të shoqërohet dhe nga dokumentacioni i poshtëshënuar:

I. Persona Fizik

- a) jetëshkrimi;
- b) një dokument që vërteton identitetin e nënshkruesit dhe faktin nëse është personi i autorizuar për të paraqitur kërkesën (pasaportë apo letërnjoftim);
- c) një referencë ose rekomandim nga punëdhënësi i mëparshëm ose ai aktual;
- d) diploma e noterizuar, për përfundimin e studimeve të ciklit të parë, sipas përcaktimeve të legjislacionit në fuqi për arsimin e lartë;
- dh) formulari i plotësuar i vetëdeklarimit të gjendjes gjyqësore;
- e) vërtetimi i përfundimit të programit të trajnimit dhe të formimit profesional të ndërmjetësve, i miratuar nga Dhoma Kombëtare e Ndërmjetësimit; program trajnimi të organizuar nga organizatat jofitimprurëse vendase ose nga organizatat e huaja apo ato ndërkombëtare
- ë) një dokument që provon pagesën e tarifës së dhënies së licencës prej 5000 (pesë mijë) lekësh.

II. Persona juridik

- a) jetëshkrimi;
- b) një kopje e noterizuar e vendimit të gjykatës për krijimin e personit juridik;
- c) vërtetimi, nga organet tatimore, për shlyerjen e rregullt të detyrimeve tatimore, në përputhje me legjislacionin në fuqi;
- d) vërtetimi i përfundimit të programit të trajnimit dhe të formimit profesional të ndërmjetësve, nga kandidatet e propozuar nga personi juridik që do të ushtrojnë veprimtarinë si ndërmjetës, i miratuar nga Dhoma Kombëtare e Ndërmjetësimit;
- e) një referencë ose rekomandim nga punëdhënësi i mëparshëm ose ai aktual i këtyre kandidatëve;
- f) diploma e noterizuar, për përfundimin e studimeve të ciklit të parë, sipas përcaktimeve të legjislacionit në fuqi për arsimin e lartë të kandidatëve;
- g) formulari i plotësuar i vetëdeklarimit të gjendjes gjyqësore;
- h) një dokument që provon pagesën e tarifës së dhënies së licencës;
- i) ekstrakti historik dhe ekstrakti i regjistrimit tregtar, të lëshuar nga Qendra Kombëtare e Regjistrimit.

Fatura e arketimit terhiqet ne sektorin e e finances, Ministria e Drejtesise